



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 6, datë 26.1.2017

PËR

KRIJIMIN E KOMITETIT RAJONAL TË LUFTËS KUNDËR TRAFIKIMIT TË PERSONAVE, NË ÇDO QARK

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës,

URDHËROJ:

1. Krijimin e Komitetit Rajonal të Luftës kundër Trafikimit të Personave në çdo qark, për mbikëqyrjen dhe bashkërendimin e veprimeve shtetërore dhe joshtetërore, për parandalimin e këtij fenomeni në mbrojtje të viktimave të trafikimit/viktimave të mundshme të trafikimit.
2. Ky komitet të kryesohet nga Prefekti i Qarkut dhe do të ketë në përbërje këta anëtarë:
 - Kryetarin e Këshillit të Qarkut;
 - Kryetarin e Bashkisë;
 - Drejtorin e Drejtorisë Vendore të Policisë; ✓
 - Drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit; ✓
 - Drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror;
 - Drejtorin Rajonal të Punësimit;
 - Drejtorin Rajonal të Shërbimit Informativ Shtetëror;
 - Drejtorin e Drejtorisë Arsimore Rajonale;
 - Drejtorin e Drejtorisë së Shëndetit Publik;
 - Drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional;
 - Drejtorin e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Në këtë komitet, kur vlerësohet e nevojshme nga anëtarët e komitetit dhe sipas çështjeve që do të trajtohen, ftohen të marrin pjesë drejtuesit e

prokurorive të rretheve gjyqësore, si dhe përfaqësues nga shoqëria civile dhe organizata e agjenci të tjera.

3. Komiteti Rajonal i Luftës kundër Trafikimit të Personave, në çdo qark, është përgjegjës për:

- identifikimin e problemeve parësore në nivel qarku, në përputhje me Strategjinë e Luftës kundër Trafikimit të Personave;
- miratimin e rregullores së funksionimit të këtij komiteti, sipas formatit tip të lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij;
- hartimin dhe miratimin e planit të veprimit në nivel qarku, për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave, i cili të jetë i harmonizuar me planin e veprimit të Strategjisë së Luftës kundër Trafikimit të Personave dhe i konsultuar paraprakisht me zëvendësministrin e Punëve të Brendshme/Koordinatorin Kombëtar për Çështjet e Luftës kundër Trafikimit të Personave;
- marrjen e masave për mbrojtjen e individëve dhe grupeve të rrezikuara nga trafikimi, në mënyrë të veçantë të grave dhe fëmijëve, duke krijuar një bazë të dhënash për të gjithë kategoritë dhe individët e rrezikuar nga trafikimi;
- ngritjen e Nënkomitetit Rajonal të Luftës kundër Trafikimit të Personave/tryeza teknike, në çdo qark, që ka të njëjtën përbërje, mënyrë raportimi dhe përgjegjësi, si tryeza teknike e komitetit rajonal. Ky nënkomitet kryesohet nga nënprefekti, i cili caktohet nga prefekti i Qarkut, sipas parashikimeve të ligjit "Për prefektin e qarkut".

4. Komiteti Rajonal i Luftës kundër Trafikimit të Personave, në çdo qark, mbledhet një herë në 3 (tre) muaj ose, në raste të veçanta, më shpesh, me kërkesën e kryetarit ose të çdo anëtari, duke njoftuar paraprakisht Koordinatorin Kombëtar për Çështjet e Luftës kundër Trafikimit të Personave.

5. Kryetari i Komitetit Rajonal të Luftës kundër Trafikimit të Personave, në çdo qark, ka këto detyra:

- Organizon veprimtarinë e komitetit, bazuar në Strategjinë Kombëtare kundër Trafikimit të Personave, ndarjen e përgjegjësiwe institucionale dhe zbatimin, në nivel qarku, të prioriteteve të veprimit antitrafik;
- Raporton në emër të Komitetit tek zëvendësministri i Punëve të Brendshme/Koordinatori Kombëtar për Çështjet e Luftës kundër Trafikimit të Personave, për zbatimin e Strategjisë Kombëtare kundër Trafikimit të Personave dhe planit të veprimit të komitetit, si dhe për

masat e aktivitetet parandaluese antitrafik në nivel qarku, një herë në 3 (tre) muaj, sipas formatit tip të lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij;

- Cakton një person nga administrata e prefektit të qarkut, i cili siguron mbështetjen administrative dhe logjistike për veprimtarinë e komitetit dhe shërben si sekretariat teknik për këtë komitet.

6. Sekretariati teknik ka këto detyra:

- Mban kontakt me të gjithë anëtarët e Komiteti Rajonal të Luftës kundër Trafikimit të Personave, në çdo qark, dhe të tryezës teknike;
- Njofton anëtarët për takimet e Komiteti Rajonal të Luftës kundër Trafikimit të Personave, në çdo qark, si dhe siguron grumbullimin dhe shkëmbimin e materialeve për takimet e planifikuara;
- Siguron mbledhjen dhe shkëmbimin e të dhënave në nivel qarku për detyrat antitrafik, si dhe administron ato për raste konkrete të trajtuara në tryezat teknike rajonale;
- Harton raportet tremujore të zbatimit të planit të veprimit të këtij komiteti.

7. Anëtarët e Komitetit Rajonal të Luftës kundër Trafikimit të Personave, në çdo qark, caktojnë persona teknike nga sektorët e tyre përkatës, duke formuar tryezën teknike rajonale, e cila kryesohet nga sekretari i Përgjithshëm i institucionit të Prefektit të Qarkut dhe do të ketë në përbërje këta anëtarë:

- Një përfaqësues nga Këshilli i Qarkut;
- Një përfaqësues nga secila bashki/ Drejtoria e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror në Bashki;
- Një përfaqësues nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve nga bashkia që ka krijuar një strukturë të tillë;
- Shefi i Seksionit për Trafiqet e Paligjshme, në Drejtorinë Vendore të Policisë;
- Një përfaqësues nga Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit;
- Një përfaqësues nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror;
- Një përfaqësues nga Drejtoria Rajonale e Punësimit;
- Një përfaqësues nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Informativ Shtetëror;
- Një përfaqësues nga Drejtoria Rajonale Arsimore;
- Një përfaqësues nga Drejtoria e Shëndetit Publik;
- Një përfaqësues nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore;
- Përfaqësues nga shoqëria civile.

Në mbledhjet e tryezës teknike ftohen të marrin pjesë përfaqësues të prokurorive të rretheve gjyqësore.

8. Tryeza teknike rajonale për çështjet e luftës kundër trafikimit të personave, në nivel qarku, mbledhet një herë në 2 (dy) muaj dhe ka këto detyra:

- Identifikon problemet parësore në fushën e luftës kundër trafikimit të personave;
- Mbledh dhe shkëmben të dhëna mbi identifikimin fillestar, referimin dhe zgjidhjen e rasteve konkrete;
- Përcakton veprimet e nevojshme për parandalimin e trafikimit dhe mbrojtjen e familjeve, grupeve, personave dhe fëmijëve në rrezik aktual ose potencial trafikimi;
- Mbikëqyr zbatimin e detyrave vendore antitrafik, në përputhje me detyrat e veçanta të çdo institucioni të përfaqësuar në komitet.

9. Tryeza teknike i raporton, me shkrim, Komitetit Rajonal të Luftës kundër Trafikimit të Personave, në çdo qark, mbi ecurinë e rasteve të trajtuara, pas çdo mbledhjeje.

10. Ngarkohet Komiteti Rajonal i Luftës kundër Trafikimit të Personave, në çdo qark, dhe tryezat teknike rajonale për zbatimin e këtij urdhri.

11. Ngarkohen zëvendësministri i Punëve të Brendshme/Koordinatori Kombëtar për Çështjet e Luftës kundër Trafikimit të Personave për monitorimin e zbatimit të këtij urdhri. ✓

12. Urdhri nr.139, datë 19.6.2006, i Kryeministrit, "Për krijimin e komiteteve rajonale të luftës kundër trafikut të qenieve njerëzore", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

